



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 59 datë 25.07. 2016

Për

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK TË TIRANËS NR. 58, DATË 30.12.2015, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2016-2018 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2016 (I NDRYSHUAR)”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, pika 1/1.3, shkronja “c”, nenit 23, nenit 25, nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 39, paragrafi i fundit dhe nenit 44, paragrafi i dytë, shkronja “a” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”(i ndryshuar); udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.1 datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58 datë 30.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” (i ndryshuar); si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”(i ndryshuar) si më poshtë:
 - a- Shpërndarjen e Financimit për projekte të reja nga FZHR për vitin 2016 në programin “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale” në shumën 153,600,000(njëqind e pesëdhjetë e tre milion e gjashtëqind mijë) lekë dhe në programin e Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit në shumën 159,881,338 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë million e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tetë)lekë sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Në zbatim të pikës 1-a, të miratojë detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve për objektet e reja të vitit 2016 të FZHR-së nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, në programin e Arsimit Parauniversitar, sipas pasqyrës nr. 2 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë rishpërndarjen e fondit të investimeve brenda Programit të Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik për vitin 2016, sipas pasqyrës nr. 3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.



4. Të miratojë një shtesë fondi në planin e investimeve në Programin e Kujdesit Social, duke pakësuar fondin rezervë për vitin 2016, sipas pasqyrës nr. 4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI